



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:081830
Datë: 14.01.2025
Numri i dokumentit: 06707807

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.427/2013

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, (në Objektivin e Gjykatës në Mitrovicë-Veri), kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët, Xhemajl Jusufi dhe Dardane Ismaili, procesmbajtësja Edita Kelmendi-Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit D.S i akuzuar për veprat penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2 KPK dhe Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 317 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.nr.40/2011 dt.13.10.2011. Në këtë çështje penale është mbajtur shqyrtimi gjyqësor që ka qenë e hapur për publikun, dhe është mbajtur në prezencën e palëve; Prokurores së Shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Barajmi, të pandehurit D.S, mbrojtëses së tij, av.Emine Kaqiku. Shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar më 10.01.2025 të njëjtën ditë është shpall publikisht aktgjykimi, ndërsa më 14.01.2025 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

- Kundër të pandehuri;

D.S me nofkën “.....”, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur më dt..... në P....., me vendbanim në M..... në Rr “.....”, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, me numër persona të identifikimit:.....;

I.

Në mbështetje të nenit 362 par.1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

REFUZOHET AKUZA

-Sepse:

Më datën 16.03.2011 rreth orës 20:30, afër ndërtesës së kuqe në M....., pa autorizim ka shpërnda, ka shit substanca dhe preparate të cilat janë shpall të rrezikshme, ashtu që i pandehuri

D.S i ka shitur personit F.P, dy qese me marihuanë në sasi prej 2.5 garm për shumën e parave prej 500 dinar. Pastaj më datën 17.03.2011, rreth orës 17:00 në Rrugën “.....” në M....., policia ka ndaluar të pandehurin F.P dhe gjatë bastisjes ka gjetur edhe sekuestruar dy qese me marihuanë ne sasi 2.5 gram.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Blerje, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope sipas nenit 229 par.2 të Kodit Penal të Kosovës.

II.

Në mbështetje të nenit 362 par.1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

REFUZOHET AKUZA

- Sepse:

Më datën 11.04.2011 rreth orës 18:30 minuta në lagjen e boshnjakëve Rr “.....” në M....., e ka kanosur dhe sulmuar personin zyrtar – të dëmtuarin N.M. Në atë mënyrë që pasi i pandehuri është ndaluar nga policia për shkak të dyshimit për veprën penale të përshkruar në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, i cili ka qenë duke udhëtuar me automjet të tipit “.....” me ngjyrë të kuqe me targa, ka dalë nga automjeti dhe menjëherë e ka shtyrë me duar dhe e ka kapur për gjoksi zyrtarin policor N.M, dhe i’u ka drejtua me fjalët: “ke me mbajt në mend për këtë”. Pastaj i pandehuri është arrestuar dhe është dërguar në stacioni policor në M....., ku prapë ka përdorur fjalë kërcënuese në raport me të dëmtuarin.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas nenit 317 par.1 të Kodit Penal të Kosovës.
- I dëmtuari N.M për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.
- I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e procedurës mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

- Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën, PP.nr...../2011 dt.13.10.2011, kundër të pandehurit D.S, për veprat penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2 KPK dhe Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga nenin 317 par.1 të KPK-së, si dhe ndaj të pandehurit F.P, për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.1 sipas Kodit Penal të Kosovës. Më datën 10.03.2021, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, nëpërmjet parashtresës e ka precizuar aktakuzën në raport me përshkrimin e veprimeve të të pandehurve dhe cilësimin juridik të veprave penale.

Më datën 01.03.2023, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin P.nr.66/2023 për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale e ka hedh akuzën dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit F.P, për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.1 te KPK-së.

- Kompetenca;

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit 9,paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra penale dyshohet se ka ndodhur në Mitrovicës dhe rrjedhimisht, bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas nenit 29, paragrafi 1 i KPP-së. Sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo natyrë e veprave penale për të cilën akuzohet i pandehuri, sipas nenit 22 par.1, nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.2 pika 1.2.66 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) hynë në kompetencë të Departamentit për krime të rënda.

- Rrjedha e procedurës:

Më datën 18.03.2021, në këtë çështje penale është mbajtur shqyrtimin fillestar në prezencën e palëve. Gjatë seancës fillestare, prokurori i çështjes është tërhequr pjesërisht nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurit D.S për veprën penale –pikën II të akuzës, për shkak të

parashkrimin absolut të ndjekjes penale. I pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.par.2 KPK-së.

Më datën 10.01.2025 është mbajtur shqyrtimi gjyqësor në prezencën palëve. Gjatë seancës fillestare, prokurorja e çështjes është tërhequr nga akuza dhe ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurit D.S në mungesë të provave fajësuese.

- Gjetjet e gjykatës:

Pasi që prokurori e shtetit në PTH- Mitrovicë, është tërhequr nga akuza dhe ndjekja penale ndaj të pandehurit D.S për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike sipas nenit 229 par.2 KPK-së dhe sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas nenit 317 par.1 të KPK-së, kjo gjykatë vlerëson se sipas nenit 51 të KPP-së, prokurori ka të drejtë ligjore që deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të tërhiqet nga ndjekja penale. Bazuar në këto arsye, kjo Gjykatë konstaton se në mungesë të aktakuzës nuk mund të vazhdohet shqyrtimi i mëtejme i kësaj çështjeje penale. Mbi këto arsye, gjykata gjen se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore që të refuzohet akuza e prokurorisë në përputhje me nenin 362 par.1 nën paragrafi 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

- Lidhur me shpenzimet e procedurës penale:

Lidhur me lirimin e të pandehurit nga pagimi i shpenzimeve të procedurës, Gjykata vendosi në mbështetje të nenit 453 par.1 të KPP-së.

- Lidhur me kërkesën pasurore juridike:

Gjykata e ka udhëzuar palën e dëmtuar në kontest civil në mbështetje të nenit 462 par.3 të KPP-së.

Nga ajo që u tha me lart u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.427/2013 datë 14.01.2025

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pas pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.